



## Titulli i projektit

Ngritja e laboratorit klinik në qendrën shëndetësore të Ishmit

## Tipi i projektit

Kohesion Social

## Vendndodhja e projektit

Ishëm

## Buxheti i paravlerësuar

30,000 Euro

## Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve

Njësia Administrative Ishëm përfshin 11 fshatra me 8500 banorë. Ajo ka një distancë relativisht të madhe gjeografike nga njësitë administrative fqinje (Manëz dhe Katund i Ri). Në Ishëm ka një qendër shëndetësore, në të cilën, për shkak të mungesës së një laboratorit klinik, nuk mund të kryehen analizat bazë shëndetësore. Për këtë arsye banorët janë të detyruar të udhëtojnë drejt Fushë-Krujës apo Durrësit.

## Qëllimi/et specifik të projektit

Qëllimi i projektit është ngritja e laboratorit klinik për analizat "gjak dhe urinë komplet" në qendrën shëndetësore të Ishmit dhe furnizimi i saj me materialet e nevojshme për analizat bazë shëndetësore për të paktën një vit. Ky laborator do t'i shërbejë jo vetëm popullatës së Ishmit, por dhe njësive administrative fqinje (kryesisht Manzës).

## Rezultatet e pritshme dhe treguesit

Rezultatet e pritshme përfshijnë:

- (a) ofrimi i plotë dhe i përmirësuar shërbimit për banorët e kësaj njësie administrative;
- (b) përmirësimi i kohesionit social;
- (c) përmirësimi i cilësisë së jetës.

Nga ngritja e laboratorit klinik do të përfitojnë 8500 banorët e Ishmit, por edhe banorët e njësive administrative fqinje, si Manëz dhe Katund i Ri. Numri i njësive administrative që përfitojnë nga kjo ndërhyrje është 2-3 (dy-tre).

# PROJEKTI 3



program i zonave funksionale

# pzf

## Aktivitetet e projektit

Kohëzgjatja e përafërt e projektit është 3-4 muaj.  
Aktivitetet e parashikuara përfshijnë identifikimin dhe blerjen e pajisjeve laboratorike dhe materialeve për kryerjen e analizave, duke ndjekur procedurat përkatëse të prokurimit dhe blerjes. Rëndësi do të ketë dhe trajnimi i stafit.

## Maturimi i projektit

Parashikohet të kryhet një vlerësim dhe listim paraprak i pajisjeve të nevojshme dhe materialeve bazë, si dhe i burimeve njerëzore. Po ashtu, në bashkëpunim me drejtorinë e shëndetësisë, do të bëhet përcaktimi i aparaturave teknike të laboratorit të ri dhe struktura organizative përkatëse.

## Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

Burim i mundshëm finacimi është skema për mbështetjen e reformës në shëndetësi, financuar nga SDC (Swiss Development Cooperation), fondi i Ministrisë së Shëndetësisë, etj.  
Ndër partnerët e mundshëm në zbatimin e këtij projekti përfshihen Ministria e Shëndetësisë, Drejtoria Rajonale e Shëndetit Publik, Bashkia Durrës (njësia administrative Ishëm), etj..

## Kostot e projektit

Duke filluar nga 30,000 Euro.